



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

### **Programi i Studimit me Karakter Profesional “Menaxhim Veteriner”**



Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Ana Kapaj (Mang)
2. Dr. Sonila Çoçoli

Dhjetor/2021

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit me karakter Profesional në “Menaxhim Veteriner” ofruar**  
**nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agroushqimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Menaxhim Veteriner
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 371, datë 05.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.59, datë 09.04.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	UBT
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE/9 PAK v.a. 2020-2021 10 PAE/ 7 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	30 Studentë v.a. 2020-2021 33 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	

## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Fan S. Noli në Korçë, është një nga universitetet publike më të konsoliduar në Shqipëri, themeluar në vitin 1992. Midis fakulteteve të këtij universiteti qëndron edhe Fakulteti Bujqësisë dhe brenda tij edhe departamenti i Agroushqimit, i cili ofron këtë program studimi.

Programi i studimit me karakter profesional në "Menaxhim Veteriner" synon arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit veterinerë, duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimit teorik me praktikën. Programi synon të zhvillojë aftësitë, shprehitë dhe kompetencat e studentëve për tu bërë profesionistë teknikë veterinerë. Nga vetë universiteti ky vlerësohet të jetë mjaft i rëndësishëm për tregun rajonal të punës.

Ky program profesional studimesh është licensuar nga Minisria e Arsimit me urdhër UMASR Nr. 371 datë 05.07.2018. Sipas dokumentit të hapjes programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019.

Hapja e këtij programi sikundër argumentohet nga vetë organet drejtuese të IAL, është diktuar nga nevoja e tregut të punës por edhe nga hapësirat ligjore të Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë për celjen e programeve profesionale.

Kurrikula e këtij programi profesional është realizuar në bashkëpunim dhe në përputhje me diplomën e integruar Mjek Veteriner të ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës. Përveç ndërtimit të kurrikulës suport është dhënë dhe vazhdon të jepet edhe me staf akademik të ftuar nga Fakulteti i Veterinarisë në Tiranë.

Qëllimi i këtij programi profesional studimi është të përgatisë teknikë veterinerë të gatshëm për tregun e punës, sidomos atë rajonal. Kompetencat profesionale të tyre do të jenë organizimi dhe menaxhimi i fermave të vogla blegtoale si dhe ekspertizë në nivel teknik të problemeve të natyrave të ndryshme veterinerë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit me karakter profesional në "Menaxhim Veteriner" filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Fan S. Noli, Korçë, u realizua gjatë datave 18-19.10.2021, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë, Përgjegjës të Departamentit të Agrorshqimit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyrë të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e FB. Gjatë këtyre takimeve u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Kordinatori Teknik i ASCAL. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Muhamed Prezja.

GVJ pasi u vu në dijeni të komenteve të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë rreth Draft-RVJ-së shprehet si më poshtë:

### **Përgjigje ndaj komenteve të sjellë nga Universiteti i Korçës**

- "Mungesa e stafit akademik të kualifikuar në këtë program studimi. Aktualisht është vetëm një staf akademik i kategorisë asistent lektor (MSc) që ka diplomë në Veterinarë"
- "...ngarkesa mesimore e disa prej asistentëve të këtij departamenti. Rast për tu përmendur është për vitin akademik 2020-2021 ngarkesa prej 10 modulesh e njërit prej asistentëve të departamentit. GVJ sygjeron që departamenti dhe Fakulteti i Bujqësisë të marrin masa urgjente për rekrutimin e stafit të ri pedagogjik, specialistë të fushave përkatëse.
- "Nga RVB si dhe vizita e grupit vlerësues u konstatua se në programin e studimit "Menaxhim Veterinar" ka një mungesë të theksuar të stafit akademik ku si për rrjedhojë pjesë të stafit aktual janë të detyruar të mbulojnë shumë module duke rritur në këtë mënyrë ngarkesën mesimore dhe rrjedhimisht duke venë në rrezik cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies."

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është në dijeni të përpjekjeve të institucionit dhe specifikisht të departamentit për rekrutimin e stafit të ri në këtë program studimesh. Gjatë vizitës dhe takimeve që u realizuan me drejtuesit dhe stafin akademik ky ishte një nga shqetësimet kryesore që u diskutuan. Megjithatë, qëllimi i këtij raporti është pasqyrimi me realitet të situatës në të cilën ndodhet programi profesional „Menaxhim Veterinar“, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës në rastin e hasjes së problematikave. Për këtë arsye GVJ e ka theksuar

në këtë vlerësim këtë mangësi me shpresën dhe bindjen që kjo do të përmirësohet në të ardhmen.

***Rekomandimet nuk ndryshojnë.***

- “.. mungesë evidence nëse është marrë ndonjë plan masash në lidhje me rezultatet e anketimit të studentëve”

Sipas RVB-së rezultatet e përftuara i vihen në dispozicion departamentit. Rezultatet e anketimit i nënshtrohen analizës dhe si individualisht, ashtu dhe në nivel departamenti merren masa për të reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vëmë në dukje se nuk është paraqitur asnjë evidencë nëse është marrë ndonjë plan masash në lidhje me rezultatet e anketimeve të studentëve.

***Rekomandimi nuk ndryshon.***

- “Megjithatë nga takimi i grupit të ekspertëve me studentët u vu re se ata kishin paqartësi në lidhje me emërtimin e diplomës së tyre duke hasur kështu edhe vështirësi në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. GVJ sygjeron një politikë informuese më intensive nga ana e institucionit për të qartësuar sa më shumë të jetë e mundur studentët e këtij programi. Paqartësia konsiston në përceptimin e gabuar që kanë studentët për nivelin e studimeve që ata zhvillojnë”

Gjatë vizitës në IAL dhe më specifikisht gjatë takimit me studentët, problematika kryesore që u diskutua ishte tipi i diplomës që ata marrin dhe paqartësia e tyre lidhur me nivelin e studimeve që ata përfundojnë. GVJ vlerëson fushatën informuese që zhvillon IAL, bazuar kjo edhe në evidencat e sjella megjithatë prova më e mirë e këtij informimi është dëshmia e studentëve, e cila në situatën konkrete mungoi.

***Rekomandimi nuk ndryshon.***

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Menaxhim Veteriner”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti i Korçës F.S.Noli (referuar më poshtë si UNIKO) është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IAL) që financohet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme (Shtojca 1.1 Statuti UNIKO). Ai është institucion i arsimit të lartë (IAL) që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të tërë (Shtojca 1.1 Statuti UNIKO) Synimi kryesor i UNIKO, Fakultetit të Bujqësisë dhe i Programit të Studimit Profesional në Menaxhim Veteriner që bën pjesë në këto struktura, është të ofrojnë arsimin profesional, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme (Shtojca 1.1 Statuti UNIKO, Shtojca 1.3 Plani Strategjik) UNIKO ka për mision “...edukimin profesional dhe kërkimin shkencor me qëllim krijimin e specialistëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel rajonal e kombëtar” Veprimtaria kërkimore-shkencore në UNIKO, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Ajo synon t’u paraprijë dhe t’u japë përgjigje sfidave të zhvillimit dhe të integritetit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëk. hësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit të eksporteve, rritjes së konkurrencës, etj., (Shtojca 1.1 Statuti UNIKO, Shtojca 1.3 Plani Strategjik) Programi i studimit në të gjitha dokumentat e ofruara, por edhe nga vizita në institucion reflekton praninë e të gjitha objektivave të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ky program synon pajisjen me njohuritë bazë mbi menaxhimin veteriner dhe ka një përmbajtje të tillë që t’u ofrojnë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës. (Shtojca 2.2, 2.3, 2.4)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>E analizuar nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, por edhe nga vizita dhe takimet me grupet e interesit, rezulton se ka një përputhshmeri midis asaj çka rregullorja dhe dokumentacioni tjetër i vënë në dispozicion nga UNIKO me atë çka përcillet apo identifikohet në terren. Kështu, në planin strategjik për zhvillimin e UNIKO vendosen disa prioritetet midis të cilave janë studentët, kërkimi dhe mësimdhënia. Plani strategjik përbën një plan konkret për të ndërtuar realitetin e UNIKO dhe përbën një pikë të fortë orientuese për të ardhmen. Kështu, në Planin Strategjik, në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare të UNIKO, janë përcaktuar</p>

	<p>qartë të gjitha drejtimet prioritare akademike e si i tillë është dhe programi profesional “Menaxhim Veteriner”, i cili në këtë frymë ndër të tjera synon të sigurojë nivel bazënjohurish për teknik veteriner si, vaksinim, diagnostikim dhe mjekim bazë, inseminimartificial, etj.(Shtojca 1.3 Plani Strategjik, Shtojca 2.2, 2.3, 2.4 Rregulloret)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Në vijueshmëri të zbatimit dhe përputhshmërisë me atë cka vendos institucioni në dokumentat themelore, si Statuti, Plani strategjik apo rregullorja, vijnë natyrshëm edhe dokumentacioni që njësia bazë e këtij programi, pra departamenti ndjek për të realizuar këtë përputhshmëri.</p> <p>Në përputhje me Strategjinë e UNIKO, dhe Rregulloren e FB, departamenti u ofron studentëve programin e studimit profesional në fushën e menaxhimit veterinar, në profilin “Menaxhim Veterinar”. Veçori e këtij programi studimi është përgatitja e teknikëve veteriner me aftësi si, vaksinim, diagnostikim dhe mjekim bazë, inseminim artificial, etj. dhe që janë të aftë të integrohen lehtësisht në tregun e punës të rajonit e më gjerë. (Shtojca 1.3 Plani Strategjik, Shtojca 2.2, 2.3, 2.4 Rregulloret)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Programi profesional i studimeve në Menaxhim Veterinar është hapur duke patur si qëllim kryesor ndikimin pozitiv të mundshëm në zhvillimin e blegtorisë për zonën e Korcës.Specifikisht ky program studimesh profesional ka si qëllim përmirësimin e punësracore, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, mbrojtjen eshëndetit të tufës dhe trajtimit të sëmundjeve, krijimin ekushteve të përshtatshme higjienikë -sanitarë, rritjen enumrit të krerëve në çdo fermë, rritjen e sigurisë ushqimore,zhvillimin e sistemeve vertikale dhe horizontale të integritetitj.</p> <p>Fakulteti i Bujqësisë ka ndërmarënjë studim fillestar të tregut të punës, ku ka bazuar edhe hapjen e programit profesional të studimit “MenaxhimVeterinar”, në Departamentin e Agorushqimit. (Shtojca 3.12, Studim Tregu). Ka qenë pikërisht ky studim qëka nxjerrënë pah nevojën e plotësimit të kërkesave dhe nevojave tëtregut të punës për teknikë veterinerë, tëdomosdoshëm për tu përballur me sfidat e zhvillimit tëblegtorisë, në funksion të plotësimit të nevojave të banorëve dhe të tregut me produkte blegtorale.</p> <p>Gjithashtu janë bërë edhe vlerësimenga disa struktura rajonale nëpërmjet drejtuesve të tyre, në formëne mbështetjes për hapjen e programit të studimit si: AKU,Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, QTTB, Kryetarët eBashkive të rajonit, Kryetare e Qarkut, Drejtuesit e FIX, TONA Company etj. (Shtojca 2.22, Mbështetje në hapje të Programit)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti Korces është një IAL e mirëorganizuar midis njësive bazë njësive kryesore si dhe brenda tyre. Këtë organizim e reflekton: ndarja midis fakulteteve dhe marrëdhëniet brenda tyre; si dhe delegimi dhe përcjellja e procedurave, analizave vjetore nga poshtë-lart-poshtë ka rezultuar mjaft eficiente për departamentet si njësi bazë dhe mjaft të rëndësishme për vetë këtë IAL.</p> <p>Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UK. Janë një sërë zyra dhe njësish përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: Sekretaritet e Departamenteve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat, Zv. Dekani për mësimin, Zv.Rektori për mësimin, etj. Një koordinim i punës së këtyre njësive ka sjellë një mbështetje të studimeve në këtë cikël profesional studimesh.</p> <p>Integriteti, cilësia dhe vlera që produkti i prodhuar nga departamenti i menaxhimit si ofruese bazë e këtij programi studimi është gërshetim jo vetëm i përkushtimit të stafit, përgjegjësive të departamentit, orintimeve të qarta të vetë IAL, por edhe të suportit të tyre përmes njësive të tjera mbështetëse.</p> <p>Ndërsa raportet me institucionet dhe bizneset kombëtare mbeten prioritet, janë të shumta përpjekjet që bën i gjithë stafi i këtij departamenti i cili shfrytëzon lidhjet e veta edhe personale duke synuar t'u ofrojë studentëve përmes praktikave apo vizitave në biznese shqiptare, etj. Nga ana tjetër nga takimi me studentët rezultoi se këto takime me biznese vendase kanë qënë mjaft eficiente. (Shtojca 1.1 Statuti UK, Shtojca 1.3 Plani Strategjik)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Një ndër sfidat kryesore të fakultetit dhe departamentit është rritja e procesit të ndërkombëtarizimit e cila do t'i shërbejë rritjes së standarteve dhe përmirësimit të cilësisë. Kjo sfida ka ardhur me rritjen e kësaj njësie bazë, me testimin dhe vlerësimin pozitiv të outputit që ky department nxjerr për tregun shqiptar, të vlerësimeve dhe mbështetjes nga bizneset shqiptare si dhe rritjes së nevojës së tregut për student cilësorë të këtij programi.</p> <p>Outputi i rezultuar nga analizat e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve ka prodhuar një perceptim dhe gjykim cilësor për të gjithë punën masive të bërë deri tani dhe me sigurinë e përputhjes me tregun.</p> <p>Raportet me institucionet ndërkombëtare kanë rritur dhe përmirësuar imazhin dhe rëndësinë e këtij departamenti. (Shtojca 2.22 Mbështetje në hapje të programit, 2.23 Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e programit ubt (fakulteti i mjekësisë veterinare) – UNIKO Fakulteti i Bujqësisë)</p> <p>Një bashkëpunim të gjerë UNIKO ka edhe me aktorë biznesi brenda vendit, ku marrëveshjet e nënshkruara ju japin përgjegjësi palëve për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese. (Shtojca 2.22 Mbështetje në hapje të programit, 2.23 Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e programit ubt (fakulteti i mjekësisë veterinare) – UNIKO Fakulteti i Bujqësisë)</p>



	<p>Nga vlerësimet e bëra nga departamenti në analizat mësimore-kërkimore ky program ka rezultuar i suksesshëm. (Vizita në IAL, Shtojca 2.20 Analiza e Veprimtarisë së UNIKO)</p> <p>Stafi është mjaft i përkushtuar dhe i orientuar drejt këtij qëllimi, po kështu qasja e UNIKO me mbështetjen dhe përkushtimin e drejtueses të departamentit, profesoratit dhe deri tek stafi më i ri.</p> <p>Institucionalisht UK ka një numër të madh marrëveshjesh me këto institucione të tjera ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertize në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit, përmes identifikimit të kërkesave të tregut dhe mundësisë që studentët të prezantohen direkt me punën në terren. (Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale, Shtojca 2.22 Mbështetje në hapje të programit, 2.23 Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e programit UBT (fakulteti i mjekësisë veterinarë) – UNIKO Fakulteti i Bujqësisë)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Programi i studimeve profesionale në Menaxhim Veteriner synon arsimimin profesional dhe kualifikimin të studentëve në fushën e teknikut veterinar duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimit teorik me praktikën. Programi synon të zhvillojë aftësitë, shprehjet dhe kompetencat e studentëve për t'u bërë teknikë të fushës së menaxhimit veterinar. Institucioni ka vendosur në kohë marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrohen. Për këtë, ekzistojnë shumë marrëveshje të realizuara nga UNIKO me institucione dhe biznese kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programeve të ofruara në UK dhe të programit në veçanti. UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi të ngushtë me Këshillin e Qarkut Korçë, Bashkinë Korçë, Pogradec, Bilisht, Pustec, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe sipërmarrje në fushën e prodhimit të produkteve ushqimore si: "AGROFRUT", "TONA CO", "FIX PRO" etj. (Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale). Nga departamenti është konsideruar, sikurse edhe nga vetë IAL, zhvillimi i praktikës si një fazë e rëndësishme që lidhet me formimin praktik të studentëve si dhe me mundësi mjaft të mira të tyre për sistemim në punë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Në funksion të këtij qëllimi, por jo vetëm, institucioni angazhon edhe zyrat mbështetëse si p.sh. zyra e karrierës e cila përmes organizimit të alumni, mbajtjes së marrëdhënieve me studentet përmes përdorimit të gjurmimit të tyre si instrument vlerësues dhe matës sasior, mundohet nga njëra anë të vlerësojë dhe të sigurohet për cilësinë e transmetuar të dijeve dhe përputhjes së tyre me atë çka kërkon tregu. Pavarësisht sfidave që kjo zyrë përballë, qënësia e saj, mbështetja që i jepet studenteve, si dhe marrëdhëniet brenda vetë IAL e kanë pozicionuar tashmë si mjaft jetike dhe strategjike për të gjithë IAL.</p>

	Mund të përmendim këtu një sërë marrëveshjesh që ky institucion ka me disa subjekte si TONA co, Agrofrut, Fix pro etj. (Aneksi 2.10Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjërë profesionale dhe specialitetesh.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi e studimeve profesionale në Menaxhim Veteriner, i ofruar nga departamenti i Agroushqimit, është i organizuar në lëndë/module ku gjithsej janë 32 prej tyre. Secili modul vlerësohet me kreditet përkatëse.</p> <p>Struktura e planit mësimor është në përputhje me legjislacionin për organizmin e planit mësimor. Disiplinat e ndryshme të formimit si, disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina karakterizuese, disiplina të ngjashme me ato karakterizuese dhe lëndët me zgjedhje, janë të harmonizuara me përqindje ligjore. Modulet janë të percaktuara sipas veprimtarisë formuese, kategorizimit të tyre dhe raporteve në përqindje (Shtojca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit). Konkretnisht në kurrikulën e këtij programi studimi shpërndarja e moduleve është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë, 5 lëndë, 20 kredite (16%, në përputhje me VKM 41)</li> <li>• Lëndë karakterizuese, 16 lëndë, 50 kredite (42%, në përputhje me VKM 41)</li> <li>• Lëndëtë ndërdisiplinore, 5 lëndë, 17 kredite (14%, në përputhje me VKM 41)</li> <li>• Lëndë plotësuese, 2 lëndë, 17 kredite (14% në përputhje me VKM 41)</li> <li>• Lëndë përmblyëse, diploma, 6 kredite (5% në përputhje me VKM 41)</li> </ul> <p>Të gjitha syllabuset e moduleve që zhvillohen në programin e studimit Menaxhim Veterinar janë të depozituara pranë Departamentit të Agroushqimit. Ato janë përditësuar sipas formatit të VKM 41 dhe pasqyrojnë të gjithë komponentët mësimore. Duke konsideruar periudhën 3-vjeçare të raportimit për efekt të akreditimit, departamenti i Menaxhim veterinar disponon edhe syllabuset e mëparshme sipas formatit të UNIKO, që është më i detajuar sa i takon përmbajtjes së praktikave, seminareve apo orëve të laboratorit. (Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e</p>

	<p>studimit, 2.8 Programet lëndore të programit të studimit – (Gjenden brenda rregulloreve të secilit vit akademik))</p> <p>Vlen të thekësojmë dhe rëndësinë që departamenti i ka dhënë zhvillimit të praktikës profesionale në këtë program studimesh profesionale. Praktika zhvillohet në 3 module të shpërndara përkatësisht në semestrin 2, 3 dhe 4. Për realizimin e praktikës profesionale, departamenti bazohet në marrëveshjet e shumta që ka me operatorë publikë dhe privatë të rajonit. (Shtojca 3.5 tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikën, Shtojca 3.6 raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Njësia bazë e ofrimit të këtij programi studimesh përbën një departament të konsoliduar ku krahas qasjes ndaj tregut dhe rrjedhimisht dhe studentit, punohet për përmirësimin e cilësisë, mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmirësimin dhe diversifikimin të metodave inovative të mësimin dhe vlerësimit të dijes. E gjitha kjo ka demonstruar dukshëm një përvojë, kapacitet dhe burime cilësore dhe sasiore për ofrimin e programeve të studimit të këtij departament</p> <p>Departamenti i Agrorshqimit si pjesë përbërëse e Fakultetit të Bujqësisë, ku ofrohet ky program studimesh, aktualisht ka një staf akademik që përbëhet nga 3 profesorë të asociuar, 2 doktorë shkencash dhe 3 MSc. Ndërkohë ky departament mbështetet dhe në një staf pedagogjik të fuar të përbërë nga 4 profesorë, 2 doktorë dhe 5 MSc.</p> <p>Problematika kryesore që grupi i vlerësimit të jashtëm hasi në këtë proces është pikërisht mungesa e stafit pedagogjik të kualifikuar për këtë program studimi. Aktualisht është vetëm një staf akademik i kategorisë asistent (MSc) që ka diplomë në Veterinari. GVJ e vlerëson këtë problematikë si një dobësi të këtij programi studimesh dhe sygjeron që të reflektohet sa më shpejt nga ana e institucionit rekrutimi i stafit efektiv të përshtatshëm me modulet që ofrohen në këtë program profesional.</p> <p>Gjithashtu konstatohet si problematikë ngarkesa mesimore e disa prej asistentëve të këtij departamenti. Rast për tu përmendur është për vitin akademik 2020-2021 ngarkesa prej 10 modulesh e njërit prej asistentëve të departamentit. GVJ sygjeron që departamenti dhe Fakulteti i Bujqësisë të marrin masa urgjente për rekrutimin e stafit të ri pedagogjik, specialistë të fushave përkatëse. (Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit</p>	<p>Departamenti si njësia bazë që ofron këtë program studimi krahas objektivave për t'i shërbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes së cilësisë dhe përmirësimin të standardeve të mësimdhënies, forcimit të marrëdhënieve me studentet, qëndërzon dhe vlerëson në mënyrë të vazhduar formimin e studentëve të këtij programi me ato aftësi, dije e kompetenca që i shërbejnë tregut, objektivave të programit dhe institucionit.</p> <p>Këto studime profesionale synojnë formimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e teknikut veteriner. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këto fusha nëpërmjet integritit të mësimin me praktikën. (Shtojca 1.3 Plani Strategjik, Shtojca 2.2, 2.3, 2.4 Rregulloret)</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

### Standardi II.1

Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë programe.</p>	<p>Programi ka regulloren e tij të studimeve ku janë të përcaktuara qartë objektivat dhe rezultatet e pritshme për studentët, si dhe mundësitë e punësimit të ardhshëm. (Shtojca 2.5 Rregullorja e programit të studimit)</p> <p>Kurrikula e këtij programi studimesh është mbështetur në kurrikulën e Universitetit Bujqësor, diploma Mjek Veterinar. Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit profesional në Menaxhim Veteriner, disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit, Plani mësimor, Klasifikimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi si dhe Syllabuset e lëndëve. (Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit, Shtojca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. (VKM nr.41 dt. 24.01.2018) Në të pasqyrohen objektiva formuese dhe kompetenca profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë një program studimi profesional.</p> <p>Kurrikula është e organizua në veprimtari formuese, bazë, karakterizuese, plotësuese dhe pëmbjllëse si tema/provim diplome. (Shtojca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit,</p>	<p>Gjithsej studentët bëjnë 32 lëndë/module, duke përfshirë këtu dhe 3 praktika profesionale. Në vitin e dytë studentët realizojnë temën/provimin final të diplomës. Në përfundim të cdo viti studenti</p>

<p>vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>mer 60 kredite për një total prej 120 kreditesh në përfundim të studimeve.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimeve profesionale në “Menaxhim Veteriner”, plani mësimor buron nga kurrikula e këtij programi studimi dhe pasqyron periudhën kohore përgjatë së cilës zhvillohet secili modul i këtij programit.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ. Ai hartohet nga Përgjegjësi i Departamentit (Njësia Bazë) dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UNIKO.</p> <p>Plani mësimor përfshin elementet e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24.01.2018:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës;</li> <li>2. Numrin e krediteve për çdo modul (kreditet për modul variojnë nga 3 - 5 ECTS)</li> <li>3. Orët në total për secilin modul (në varësi të llojit të lëndës, variojnë nga 75-125 orë) dhe raporti i orëve - leksion/seminar varion në varësi të llojit të lëndës;</li> <li>4. Detyrimet për secilin modul (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli);</li> <li>5. Periudha (në varësi të semestrit që zhvillohet 1,2,3,4) dhe mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul (provim ose kolokium – rezulton provim për të gjitha lëndët);</li> <li>6. Mënyra e zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me gojë, me shkrim, me gojë&amp; me shkrim). (Shtojca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit).</li> </ol> <p>Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve, në programin e stu limit profesional në “Menaxhim Veteriner”, është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2).</p> <p>Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit).</p> <p>Në fillim të cdo viti akademik pedagogu i lëndës i njeh studentët me komponentët kryesorë të saj se dhe me detyrimet dhe përgjegjësitë përgjatë zhvillimit të asaj lënde. Programet lëndore vihen në dispozicion edhe nëpërmjet sistemit ESSE3. (Vizita në IAL)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.2**

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të studimeve profesionale “Menaxhim Veterinar” ka të specifikuar qartë emrat e moduleve, shpërndarjen e oreve, kreditet për çdo modul e kështu me rradhë. Në këtë program përfshihen disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina të formimit karakterizues të programit dhe disiplina formuese me zgjedhje, aftësive komunikative, praktika profesionale dhe teza e diplomës, të cilat do të realizojnë në total 120 kredite. (Shtojca 2.7Plani mësimor i programit të studimit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të këtij programi studimi mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit veteriner duke i dhënë atyre mundësi të mira punësimi në këtë fushë. Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, mësuam se orët e mësimit megjithëse kanë qënë online si shkak i pandemisë (leksione, seminare, ushtrime) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Në planin mësimor të këtij programi studimi, për secilën lëndë, gjejmë të pasqyruara shpërndarjen e orëve për leksione dhe seminare në auditor. Modulet e kurrikulës në këtë program studimi kanë një shpërndarje të barabartë në lidhje me ngarkesën mësimore dhe kreditet përgjatë 4 semestrave. Ngarkesa total në kredite për 4 semestrat është 120 ECTS, (Shtojca 2.7Plani mësimor i programit të studimit). Kjo shpërndarje e ngarkesës i mundëson studentëve të arrijnë objektivat formues të programit si dhe rezultate të pritshme në mësimnxënie dhe praktikë profesionale. Në takimin e realizuar me studentët mësuam se ata nuk ndiejnë se ka ngarkesë apo pamundësi për tu përgatitur siç duhet gjatë një semestri. Koha është e mjaftueshme për përgatitjen e çdo lënde dhe për rrjedhojë arritjen e rezultateve të dëshiruara.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Ndarja e lëndëve me karakter formues ndaj atyre aplikative krijon mundësinë për të fituar njohuritë teorike dhe mundëson aftësimin gradual praktik. Studenti, në 15 javë mësimore, gjatë leksioneve merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve studentët analizojë çështjet e leksionit, si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimin dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i praktikës ndihmon në kuptimin dhe përdorimin e teknikave të mësuara në teori. Në kurrikul janë parashikuar në masën 14% disiplina tëngjashme ose/dhe integruese</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ndarja e lëndëve me karakter formues ndaj atyre aplikative krijon mundësinë për të fituar njohuritë teorike dhe mundëson aftësimin gradual praktik. Studenti, në 15 javë mësimore, gjatë leksioneve merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve studentët analizojë çështjet e leksionit, si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimin dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i praktikës ndihmon në kuptimin dhe përdorimin e teknikave të mësuara në teori. Në kurrikul janë parashikuar në masën 14% disiplina tëngjashme ose/dhe integruese</p>

	<p>që lidhen me disiplinat karakterizuese në mënyrë që të aftësohen studentët për të qenë fleksibël dhe gjithëpërfshirës. Këtu përfshihen module si: higjenë veterinarë, zooteniki + të ushqyer, diagnozë laboratorike, legjislacion veterinar dhe terminologji mjekësore. (Shtojca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit).</p> <p>Struktura e këtij programi studimi, duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, është në përputhje me profilin e këtij programi profesional studimesh. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës në fushën e agrobiznesit.</p> <p>Lidhur me kurrikulën e studimeve, duke u nisur nga vetë emërtimi i këtij programi studimesh, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, sygjeron që të përfshihej ndonjë modul me karakter manaxherial, gjithmonë duke patur si synim kryesor aftësimin e studentëve për manaxhimin e fermave blektorale në të ardhmen.</p> <p>Siç doli në pah edhe nga diskutimi i realizuar me grupin e vlerësimit të brendshëm, për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperiencat nga fakultete të tjera që ofrojnë programe me profil të ngjashëm. Baza nga është inicuar ky program është (ploma e integruar "Mjek Veterinar" e ofruar nga Universiteti Bujqësor I Tiranës.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënies dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetet e tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	<p>Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit profesional në "Menaxhim Veterinar", është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2).</p> <p>Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca no.2). (Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit)</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përmthje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik pedagogu i lëndës i njuh studentët me komponentët kryesorë të saj se dhe me detyrimet dhe përgjegjësitë përgjatë zhvillimit të asaj lënde. Programet lëndore vihen në dispozicion edhe nëpërmjet sistemt ESSE3. (Vizita në IAL)</p> <p>Numri i përgjithshëm i moduleve është 32 module të organizuara në 9 lëndë duke përfshirë 3 moduletë praktikës profesionale dhe një modul të tezës së diplomës.Ngarkesa në kredite e çdonjërit nga modulet merr në konsideratë volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.</p> <p>Programi i studimit i miratuar në Department e Agroushqimit dhe më pas në Senatin akademik të UNIKO, përmban informacione të plota për temat e leksioneve, punët e laboratorit, seminarët, detyra dhe projekte kursi si edhe ngarkesat e praktikës profesionale për secilën lëndë. Dosja e plotë e programit të studimit të Menaxhim veterinarit gjendet në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit).</p> <p>Departamenti në vazhdimësikrijon mundësi për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të çdo lënde, bazuar në kërkesat e stafit pedagogjik apo inicuar nga ndonjë studim tregu. Të gjitha propozimet e reja qoftë për lëndë të reja apo për tema të reja brenda lëndës diskutohen në department dhe miratohen përpara fillimit të ri akademik dhe miratimit në Senatin akademik. Kurrikula aktuale ka ndryshuar në vitin 2020 me qëllim ndryshimin e kohës së zhvillimit të praktikës profesionale si dhe të ngarkesës së disa moduleve (Shtojca 2.12 Procedura e ndryshimeve në planin mësimor, rishikimi i kurrikulës)</p> <p>UNIKO ka një ërë marëveshjesht bashkëpunimi me institucionet rajonale publike dhe privateqëpërbushin nevojat e realizimit të praktikës të programit të studimit duke garantuar formimin praktik në profesional të studentëve. Gjithashtu këto marëveshje ndihmojnë më pas për punësimin e mundshëm pranë këtyre institucioneve apo njësive private.</p> <p>(Shtojca shtojca 3.5Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat.pdf; 3.6 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit.pdf 2.13 Tabela përmbledhëse programi i praktikës profesionale mësimore)</p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Referuar RVB- së dhe takimit me drejtuesit e Institucionit, u konstau se Insitucioni disponon: Statutin e Universitetit “Fan S. Noli” (Shtojca 1.1) dhe “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO”, si dhe Draftstatutin e UNIKO (Shtojca 1.1.1), rregulloren e UNIKO(Shtojca 1.2) të cilët bëjnë të mundur rregullimin e kuadrit të përgjithshëm institucional për mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p>Instituconi i kushton një rëndësi të vecantë zhvillimit të metodave inovative në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjinë e informacionit dhe duke ndërthurur teorinë me praktikën, “Udhëzuesi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies”(Shtojca 2.18).</p> <p>Gjithashtu sipas “Rregullores së programit të studimit “Menaxhim Veterinar”(Shtojca 2.5), e cila përcakton metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë përfshijne në mënyrë të balancuar leksionet, seminarët, laboratorët, deyrat e kyrsit, praktikat profesionale dhe klinike të cilat janë të paqyruara jo vetëm në planin mësimor por të detajuara edhe në sillabuset e secilit modul (shtojca 2.7; 2.8), të depozituara pranë departamentit.</p> <p>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik, ai vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, për çdo semester, aftësitë e mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të brendshëm nëpërmjet pyetësorit te studentëve (Statuti i UNIKO dhe anketa me studentët) (Shtojca 1.1, 3.13) të cilin e organizon në fund të çdo semestri dhe në mënyrë indirekte me anë të oreve të të mësimit nga pedagogët më me eksperience.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin drejtues dhe studentet u konstatua se studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre per stafin akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik.</p> <p>Sipas RVB-së rezultatet e përfuara i vihen në dispozicion departamentit. Rezultatet e anketimit i nënshtrohen analizës dhe si individualisht, ashtu dhe në nivel departamenti merren masa për të reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vëmë në dukje se nuk është paraqitur asnjë evidencë nëse është marrë ndonjë plan masash në lidhje me rezultatet e anketimeve të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me snembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	

	Institucioni mbështet stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies nepermjet pjese marrjes në projekte Tempus dhe Erasmus+ me qëllim që ata të përfitojnë nga metoda të reja nga pedagogë të huaj (Shtojca 2.19; 3.18).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Në realizimin e procesit mësimor Cikli i studimit "Menaxhim Veterinar" përdor metoda të ndryshme mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare.  Të gjithë auditorët janë të pajisur me videoprojektorë dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu laboratorët në funksion të kryerjes së praktikave janë të mirëpajisur dhe mundësojnë kryerjen e mësimit me metoda bashkëkohore(shtojca 4.3).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional.
<b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Për të gjitha modulet e programit mësimor "Menaxhim Veterinar" ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe. Kjo literaturë përfshin materiale të botuara apo dispenca të përgatitura nga pedagogët përkatës si dhe nga pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të UBT të cilat janë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në Bibliotekën e Fakultetit dhe atë të përgjithshme UNIKO(Shtojca 4.2).
<b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të universitetit ekziston një librari elektronike e Universitetit (EBSCO, U-Library) që mundëson aksesimin online të revistave shkencore
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe	

studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	dhe librave të menaxhimit veterinar dhe të degëve të tjera në UNIKO( <a href="https://search.ebscohost.com">https://search.ebscohost.com</a> ) (Shtojca 5.3).			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik përdor në funksion të mësimdhënies platformën online (E-learning)(Shtojca 5.5) Microsoft Office 365. Sistemi i brendshëm i komunikimit ( <a href="https://www.uniko.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.uniko.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a> ) (Shtojca 5.4)funksionon si hapësirë e nevojshme për ndërveprimin, këmbimin e informacioneve dhe aksesin në dokumentacion elektronik si të studentëve, ashtu edhe pedagogëve.  Çdo individ ka hapësirën e vet të dedikuar dhe informacioni i këmbyer mund të jetë privat ose në grup. Për t'i aksesuar, individët janë të pajisur me adresa elektronike personale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

<b>Krite, et</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Për vlerësimin dhe monitorimin në nivel institucioni është në funksionon “Sektori i Kurrikulave, Vlerësimit Institucional dhe Alumni “Qendra e Karrierës dhe Alumni”, pjesë e “Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional”(Shtojca 1.5).  Përgjegjësi i departamentit është përgjegjës për ecurinë e procesit mësimor dhe garantimin e cilësisë së tij. Në Fakultetin e Bujqësisë njësia bazë që është departamenti, cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë (Shtojca 1.5, Kreu V, neni 24), i cili është përgjegjës për koordinimin e procedurave të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Çdo 2 vjet bëhet një vlerësim i brendshëm i programit të studimit, ku hartohet një raport i cili diskutohet me të gjithë anëtarët e departamentit dhe lihen detyra (Shtojca 3.8).  Po ashtu njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson dhe garanton në tërësi procesin e mësimdhënies në të gjithë
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	

<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>komponentët e tij duke e monitoruar zhvillimin e programit të studimit dhe ecurinë e departamentit(Shtojca 3.4; 3.7).</p> <p>Alokimi i fondeve për projekte kërkimi, si nga fonde të Universitetit, MASR-së, si dhe fonde të huaja përdoren për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies(Shtojca 2.4).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Shkollat pasuniversitare, shkollat e doktoraturës, marrja e titujve dhe gradave janë disa prej kualifikimeve që personeli i departamentit të menaxhimit veterinar ka mangësi dhe duhet ti kushtoj rëndësi me synim përmirësimin të cilësisë së kërkimit shkencor.</p> <p>Njësia bazë (Departamenti) çdo vit diskuton mbi analizën mesimore dhe shkencore. Kjo analizë zgjerohet më pas në nivel fakulteti dhe universiteti(Shtojca 2.20).</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.4</b></p> <p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve.</p> <p>Të gjitha procedurat evidentohen në rregulloren e studimeve universitare (Shtojca 1.2)dhe gjithashtu edhe në rregulloren e programit të studimit “Menaxhim Veterinar”(shtojca 2.5).</p> <p>Në rregullore përcaktohen saktë frekuentimi në veprimtaritë e ndryshme formuese, si dhe format e studimit dhe të vlerësimit, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit. Vlerësimi i studentit përcaktohet në mënyrë të veçantë, sipas rregullores edhe në syllabuset e secilit modul, të cilat bëhen publike brenda departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Departamenti, si dhe secili pedagog informon studentët në fillim të vitit shkollor jo vetëm për syllabuset dhe temat e lëndës, por edhe me mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset</p>	<p>Departamenti, si dhe secili pedagog informon studentët në fillim të vitit shkollor jo vetëm për syllabuset dhe temat e lëndës, por edhe me mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të tyre.</p>

e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Kontrolli i dijeve në programin "Menaxhim Veterinar", bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes provimeve me shkrim, të ndërmjetëm dhe përfundimtar (Shtojca 3.24) ku studenti përfiton pikë, të cilat mbledhen dhe përkthehen në notë, sipas një tabelë të njësuar konvertimi, pikëve të provimit u shtohen edhe ato të vlerësimit bazuar në detyrat e kursit, projekteve, gjithashtu studentët vlerësohen edhe për praktikën profesionale.			
<b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimitetin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve.			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi përfundimtar i studentit, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e vazhdueshëm, realizohet me provim, nga komisioni i provimit që përcaktohet nga përgjegjësi i Departamentit, në jo më pak se dy antarë.			
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Antarët e komisionit janë pjesë e gjithë procesit të provimit nga fillimi deri tek hedhja e notave dhe firmosja e procesverbaleve, e cila realizohet prej të dy antarëve ku njëri prej antarëve është gjithmonë titullari i lëndës(Shtojca 3.25). Nga takimi me studentët u konststua se ata pasi njihen me vlerësimin kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij. Kjo ankesë i drejtohet dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë ose jo dhe merr vendimin përkatës. Ne rastet kur dekani gjykon se ankesa është e drejtë, Ai e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit dhe vendos, në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, për ndryshimin e komisionit dhe për rridhënien e provimit brenda ditës ose ë nesërmen, pas përfundimit të tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e	Programi i studimit realizohet në 2 vite akademike, 4 semestra dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në

<p>afësisive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor (Shtojca 3.19).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësisive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit “Menaxhim Veterinar” mundëson formim bashkëkohor të studentëve, iu ofron studentëve njohuri të qëndrueshme në shkencat teorike bazë si Anatomia e Kafsheve, Fiziologjia, Biologjia etj., formim të gjerë dhe njohuri të thelluara në çështjet teroike dhe praktike veterinare dhe të menaxhimit të problematikave veterinare në ferma si Mikrobiologjia, Patologjia, Farmakologjia, Kontrolli i Produkteve me Origjinë Shtazore etj.</p> <p>Gjithashtu në këtë program studimi trajtohen lëndë të cilat kanë si synim ndërveprimin social, komunikimin, gjuhën e huaja si latinisht e anglisht, teknologjinë e informacionit apo legjisllacionin veterinar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia dhe programi mësimor përgatit studentin të trasmetojë kompetencën të cilat do t’u shërbejnë në tregun e punës. Për realizimin e këtyre kompetencave institucioni ka nënshkruar marrëveshje me shumë institucione shtetërore dhe private, në bazë të të cilave studentëve të programit të studimit ju mundësohet kryerja e laboratoreve klinike në terren apo zhvillimi i praktikës profesionale (shtojca 2.10; 3.6; 3.5).</p> <p>Testimi i njohurive të përftuara për vlerësimin e kompetencave të studentit bëhet gjatë seminareve, kolekiumeve si dhe provimet për cdo lëndë apo për praktiken profesionale në përfundim të saj. Për këtë qëllim pedagogu harton një grup pyetjesh orientuese për përgatitjen e lëndës për provim nga studenti (shtojca 3.27).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Provimet e përgjithshme përfundimtare është konceptuar si përmbledhje dhe eksplorim i njohurive të dhëna gjatë tërë periudhës së studimit dhe duke e organizuar në varësi të peshës specifike të lëndëve dhe moduleve.</p> <p>Provimet përfundimtar vlerësohet me notë, nga një komision i përbërë nga lektorët të Departamentit. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj institucionit dhe ka përmbushur detyrimet përmblyesë të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedurën të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistrën zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar</p>	

bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kritcret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit veterinar ndjek një politikë të punësimit me kohë të plotë, sa herë është e nevojshme për të përmoushur të gjitha nevojat e tij. Kriteret e punësimit për çdo pozicion vakant pune publikohen në faqen e internetit dhe në Buletinin Javor të Agjencisë së Prokurimit Publik (Shtojca 1.4). Për zhvillimin e konkursit Dekani ngrre një komision të përbërë nga përfaqësues të departamentit, të Fakultetit dhe të Universitetit.</p> <p>Në komision, marrin pjesë zëvendësrektori, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Komunikimit dhe Promocionit dhe përgjegjësi i departamentit. Komisioni harton dhe i paraqet rektorit për miratim pikët e vlerësimit për çdo kriter të veçantë.</p>
<p><b>Kriteri2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>UNIKO përcakton në rregulloren e brendshme kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit duke respektuar aktet në fuqi (Shtojca 1.23) dhe rekruton me përparësi personel akademik të kualifikuar në universitete të njohura në shkallëndërkombëtare, duke ngritur komisione të posaçmekonvertimi të notës dhe garantuar prioritet në përzgjedhjen e tyre (Shtojca 1.13; 2.24).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Në rregulloret e programit, në analizat vjetore të departamentit, në raportimet e ngarkesa etj përcaktohen dhe mbahen të dhëna për personelin e angazhuar në programin e studimit (Shtojca 3.8; 4.4).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga RVB si dhe vizita e grupit vlerësues u konstatua se në programin e studimit "Menaxhim Veterinar" ka një mungesë të theksuar të stafit akademik ku si për rrjedhojë pjesë të stafit aktual janë të detyruar të mbulojnë shumë module duke rritur në këtë mënyrë ngarkesën mësimore dhe rrjedhimisht duke venë në rrezik cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe vizitës së Grupit të Jashtëm Vlerësues, Menaxhimi Veterinar është lokalizuar në godinen qendrore të Fakultetit të Bujqësisë. Nga pikëpamja e organizimit të ambjenteve Departamenti i Menaxhimit veterinar ka në dispozicion të veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore-shkencore një numër të konsiderueshëm ambjentesh për zhvillimin e inisiorit të vet.</p> <p>Kjo është e organizuar në: 3 Salla leksionesh, 6 Salla seminarez, 4 Laboratorë, ambjente ndihmëse, sekretari mësimore, bibliotekë, sallë informatike etj (Shtojca 4.3).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha këto ambjente janë të mirëorganizuar dhe krijojnë facilitate për kryerjen e leksioneve dhe praktikave mësimore.</p> <p>Sallat dhe laboratorët e vëzhguara gjatë vizitës përmbanin të gjitha aparaturat apo mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>moduleve të përfshira në këtë program duke bërë të mundur aftësimin teorik e praktik për studentët.</p> <p>Gjithashtu për studentët e menaxhimit veterinar janë në dispozicion (të evidentuara me marrëveshje) për kryerjen e praktikave të ndryshme si dhe ato profesionale, laboratorë institucionalë të sigurisë ushqimore, punishte të përpunimit të produkteve, thertore, apo mjediset e QTTB, baza prodhuese të shkollës bujqësore Irakli Terova etj.(Shtojca 4.3; 3.5; ).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë mësimore e pajisur gjithashtu me vende leximi, internet dhe fotokopje.</p> <p>Referuar RVB-së kjo bibliotekë përmban rreth 22 mijë libra e revista, me rreth 15 mijë tituj, të cilat shfrytëzohen nga studentët e pedagogët të Fakultetit të Bujqësisë. Rreth 3 mijë libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohet në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe rreth 19 mijë në gjuhën shqipe(Shtojca 4.2; 5.3).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse në gjuhën shqipe e cila është e përshtatshme për modulet të cilat përfshihen në Menaxhimin Veterinar.</p>

<p>moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu është në funksionon biblioteka dixhitale “U-library” e ngritur në bashkëpunim me RASH e cila ofron aksesin në EBSCO për stafin akademik dhe studentët e UNIKO.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Çdo vit, përpara miratimit të buxhetit(Shtojca 3.15), departamenti paraqet projekt propozimet e tij, në të cilat përfshihet edhe nevoja për literaturën bazë apo literaturë shtesë, e cila mund t’ju vijë në ndihmë pedagogëve dhe studentëve.</p> <p>Përdorimi i fondeve publike nga UNIKO bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Referuar RVB-se UNIKO funksionon sipas parimit të autonomisë financiare. Drejtoria Financiare (Shtojca 1.8)dhe Drejtoria Ekonomike hartojnë një plan buxhetor afatmesëm, i cili përditësohet çdo vit. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga UNIKO përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës (Shtojca 1.7).</p> <p>UNIKO financohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i shtetit;</li> <li>- Pagesat e studentëve për arsimim;</li> <li>- Të ardhurat për shërbimet e kryera;</li> <li>- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;</li> <li>- Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;</li> <li>- Veprimtari kërkimore-shkencore.</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Ndarja e të ardhurave (Shtojca 1.8.1)është me kategori sipas burimeve financiare. Shpenzimet kategorizohen sipas llogarive përkatëse. Raportet financiare mbahen në zyrën e financës. Bilance vjetore pasqyrojnë gjendjen financiare, kapacitetet për situatën financiare, numrin e studentëve për gjenerimin e të ardhurave.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakterprofesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhediplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Instituconi ka hartuar dhe zbaton kriteret të qarta (Shtojca 5.1) për pranimin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ai zbaton procedura për vlerësimin e studentëve, përparimin e tyre gjatë gjithë ciklit të studimeve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Në raste e degë të caktuara departamentet vendosin kriteret shtesë për pranimin e kandidatëve. Në rastin e programit të studimit “Menaxhim Veterinar” nuk ka kriteret shtesë për kandidatët të cilët aplikojnë për të vazhduar studimet. Për pranimet e reja sipas edhe përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi departamenti përcakton kuota të veçanta edhe për kategoritë e veçanta ndër të cilët edhe për shtetasit e huaj (Shtojca 3.9).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Departamentet, nëpërmjet veprimtarive konkrete bashkëpunuese me shkolla të mesme të qytetit, realizojnë promovimin e fakultetit dhe programeve që ofron ai. Të gjitha kriteret bëhen publike për kandidatët dhe janë të shpallura në faqen zyrtare të institucionit, megjithatë prej disa kohësh kjo faqe nuk është aktive dhe e disponueshme për këtë arsye mendojmë se duhet të jetë e udhës të bëhet funksionale sa më parë të jetë e mundur (Shtojca 3.9; 5.8).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Para periudhës së aplikimit për regjistrim departamenti, si pjesë përbërëse e FB, vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh, sipas një grafiku, të cilët japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen e tyre, Rregulloren e Universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të studimeve në institucione të tjera brenda ose jashtë vendit (Shtojca 3.10).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në UNIKO janë ngritur struktura organizative, që garantojnë të drejtën e studentëve për t’u informuar. Informimi i studentëve realizohet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni (Shtojca 3.11; 5.8) si dhe përmes sekretarive mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Si mjete për të realizuar komunikimin e jashtëm shërbejnë edhe telefonatat, e-mail (Shtojca 5.1) dhe tele-konferencat. Website i UNIKO është një mjet shumë i rëndësishëm për informimin e jashtëm por edhe të brendshëm por për shkak se kjo faqe prej disa kohësh nuk është funksionale ka mangësi në marrjen e informacionit përkatës, për këtë arsye mendojmë se duhet të merren sa më parë masa për të rregulluar atë dhe rifreskuar informacionin e nevojshëm.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	UNIKO ka aktualisht në funksion sistemin e menaxhimit të informacionit ESSE3, një program ky i mbështetur nga MASH. Këto sisteme të menaxhimit të informacionit janë përdorur për të siguruar informacionin strategjik që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Këto sisteme kanë të integruara platformë dhe module që bëjnë të mundur komunikimin ndër-aktiv midis pedagogëve dhe studentëve. UNIKO zbaton rregulla të qarta për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve respektive të vendit të punës për çdo drejtori.  Në të njëjtën kohë sistemet e menaxhimit të informacionit, mundësojnë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ si dhe raportimin në kohë reale për organet drejtuese.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në zbatim të nenin 4, të Ligjit nr. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit”, UNIKO publikon në faqen zyrtare (Shtojca 5.1), të gjitha të dhënat statistikore në lidhje me: numrin e studentëve sipas programeve; ofertën akademike; ndërtimin dhe funksionimin e institucionit; si dhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sekretariatë Mësimore pranë çdo njësie bazë, janë kontakti i drejtpërdrejtë i studentit me UNIKO, pasi e gjithë procedura e regjistrimit të tyre realizohet pikërisht pranë sekretarisë mësimore sipas përcaktimeve të rregullores së sekretarive mësimore (Shtojca 1.10).
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Çdo studenti i krijohet dosja me të dhënat personale. Ajo administrohet nga sekretaria mësimore, e cila është e detyruar të përditësojë vazhdimisht dosjen e çdo studenti nga momenti, që ai merr një status të tillë. Mbi bazën e të dhënave të depozituara në dosje, studenti informohet në vazhdimësi.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Po kështu rregullorja e Fakultetit të Bujqësisë, përcakton regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe statistikave vjetore për të diplomuarit sipas rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale (Shtojca 1.9). Çdo student ka adresën e tij të emailit në formatin embiemër@uniko.edu.al që është një ndër formatet e komunikimit midis tij dhe Institucionit. Komunikimi i personelit

	<p>akademik me studentët bëhet i mundur edhe përmes orareve të pritjes të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde.</p> <p>Universiteti ka vënë në dispozicion një ëbsite ku jepen informacione mbi planin mësimor për cilindo program studimi, i cili jep të dhëna të detajuara për lëndët dhe modulet, për personelin akademik si dhe për aktivitetet e ndryshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Për orientimin dhe këshillimin e studentëve përgjatë të gjitha cikleve të studimit, si dhe daljen në tregun e punës pas përfundimit të programit të studimit UNIKO ka vënë në dispozicion Qendren e Karrierës dhe Alumnisi dhe përfaqësuesit e Këshillit Studentor(Shtojca 1.5).</p> <p>Departamentet, për promovimin e fakultetit dhe programeve që ai ofron kryejne vizita në shkolla të mesme të qytetit (Shtojca 3.10).</p> <p>Gjithashtu të gjitha kriteret bëhen publike për kandidatët dhe janë të shpallura në faqen zyrtare të institucionit(Shtojca 3.9). Institucioni ndjek një politikë të afrimit dhe mirëpritjes së studentëve të huaj dhe synon nxitjen e mobiliteteve të studentëve të huaj, përmes marrëveshjeve ndërinstucionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit përcakton me ligj procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e</p>	<p>Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriterin e mesatares</p>

kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	së programit të studimit të nivelit të parë dhe intervistës në institucion, duke respektuar renditjen sipas pikëzimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Para periudhës së aplikimit për regjistrim departamenti, vë në dispozicion të maturantëve të grupe pedagogësh, sipas një grafiku, të cilët japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen e tyre, Rregulloren e Universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të studimeve në institucione të tjera brenda ose jashtë vendit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fakultet organizohen edhe ditë të hapura me maturantët për të informuar rreth programeve të studimit, këshillimit të karrierës dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, si dhe veprimtari të ndryshme promovuese për programet e studimit.(Shtojca 5.9)			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Në UNIKO janë ngritur struktura organizative, që garantojnë të drejtën e studentëve për t'u informuar. Informimi i studentëve realizohet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni si dhe përmes sekretarive mësimore.  Edhe pse Universiteti ka vënë në dispozicion një ëbsite ku jepen informacione mbi planin mësimor për cilindo program studimi, i cili jep të dhëna të detajuara për lëndët dhe modulet si dhe ka depozituar sillabuset e pedagogëve të cilat japin informacionin e nevojshëm për përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese (shtojca 3.26; 5.1), duhet të theksojmë faktin se ky website për momentin nuk është funksional dhe duhet ti kushtohet një vëmendje e vecantë për rregullimin e tij sa më parë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit	

e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të tjera për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Qendrës së Karrierës. Qendra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentët e diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale, të gjitha këto të dhëna janë evidentuar në raportin e Analizës Vjetore të Qendrës së Karrierës dhe Alumni (Shtojca 3.20) .			
<b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Megjithatë nga takimi i grupit të ekspertëve me studentët u vu re se ata kishin paqartësi në lidhje me emërtimin e diplomës së tyre duke hasur kështu edhe vështirësi në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. GVJ sygjeron një politikë informuese më intensive nga ana e institucionit për të qartësuar sa më shumë të jetë e mundur studentët e këtij programi. Paqartësia konsiston në përceptimin e gabuar që kanë studentët për nivelin e studimeve që ata zhvillojnë.			
<b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Megjithatë nga takimi i grupit të ekspertëve me studentët u vu re se ata kishin paqartësi në lidhje me emërtimin e diplomës së tyre duke hasur kështu edhe vështirësi në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. GVJ sygjeron një politikë informuese më intensive nga ana e institucionit për të qartësuar sa më shumë të jetë e mundur studentët e këtij programi. Paqartësia konsiston në përceptimin e gabuar që kanë studentët për nivelin e studimeve që ata zhvillojnë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikën vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi. Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit "Menaxhim Veterinar" në këtë vit akademik ishte 27 studentë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën ESSE3 që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës si sekretaria, dega mësimore dhe tutori akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit	Në RVB por edhe në dokumentat shoqëruese nuk evidenohet që Institucioni ka hartuar raporte analitike periodike mbi profilit dhe

të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse ekëshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit tëstudimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar RVB si dhe nga takimi me grupin e studenteve, atyre iu garantohen të drejta për t'u përfshirë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim që përcaktohen në rregulloret e Universitetit dhe njësisë kryesore(Neni 68; 69 shtojca 1.1, kreu 12 shtojca 2.2).  Studentët përfshihen në Senatin akademik (Shtojca 1.11)duke u zgjedhur 2 përfaqësues të tyre sipas përcaktimeve të rregullores për zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese(Shtojca 1.19), në këshillin e etikës(Shtojca 1.20), në njësitë për sigurimin e cilësisë(Shtojca 3.4) etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni, me qëllim realizimin e interesave dhe pritshmërisë akademike të çdo studenti, ka caktuar personin e kontaktit të vendosur pranë çdo Njësie Bazë, të cilët orientojnë studentët në raport me programin e studimit. Pedagogët e lëndëve mbajnë kontakte të vazhdueshme për t'u njohur me ecurinë e mësimdhënies, ngarkesës dhe mundësinë për korrigjime, pa cenuar thelbin e programeve lëndore. E drejta e studentëve për të shprehur mendime apo propozime për planet mësimore merret parasysh. Studentët kanë të drejtën të propozojnë pranë njësisë bazë, DAGU, idetë apo interesat e tyre mbi planet mësimore dhe njësia bazë i merr parasysh ato në rastin kur vendos për ndryshimin e planit mësimor.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	UNIKO inkurajon pjesëmarrjen e studentëve jo vetëm në jetën studentore, por edhe në vendimmarrje. Këshilli Studentor(Shtojca 1.17) është një formë vetorganizimi i studentëve në rang fakulteti
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të	



<p>rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>dhe në rang Universiteti, me qëllim promovimin dhe koordinimin e tyre për përfaqësim në organet drejtuese.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Vetë UNIKO sanksionon këtë të drejtë të organizimit të studentëve në Statutin dhe Rregulloren e tij. Nëpërmjet këtyre organizmave, studentëve u krijohet mundësia për të shprehur mendime lidhur me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi V.5</b></p> <p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Universiteti përmes Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, informon, këshillon, ndjek përparimin e studentëve dhe i asiston ata për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit (Shtojca 1.5). Institucioni mbështet studentët e tij në të gjitha ciklet e studimeve që ofrohen, duke u dhënë përparësi në ciklin e dytë dhe të tretë të studimit, studentëve të po këtij institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni orienton dhe këshillon studentët përgjatë të gjitha cikleve të studimit, si dhe përgjatë kalimeve nga cikli i parë i studimit në ciklin e dytë dhe të tretë, orienton studentët për daljen e tyre në tregun e punës (Shtojca 3.20).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UNIKO u ofron mundësi ndihme për integrimin në tregun e punës studentëve sa përmes trajnimeve që organizon në lidhje me mënyrat e aplikimit për punësim, hartimin e një kurrikulumi, sjelljen gjatë një interviste pune etj. aq edhe përmes vetë aktiviteteve që ai organizon si Panairi i Punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	

autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim Veterinar” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “FanS. Noli”, Korçë**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Program strategjik për zonën mbështetur kryesisht në nevojat e tregut rajonal.
2. Mundësi të mira punësimi në tregun rajonal dhe më gjerë.
3. Njësitë bazë përgjegjëse, drejtuesit dhe stafi akademik, të motivuar dhe të angazhuar optimalisht në arritjen e objektivave të programit dhe në mbështetje, orientim dhe nxitje të studentëve të programit.
4. Staf administrativ i motivuar dhe i angazhuar për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga pozicionet e tyre të punës.
5. Infrastruktura fizike e përshtatshme.
6. Mbështetja fillestare dhe e vazhdueshme nga fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës.
7. Marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, institucione qeveritare, biznese të ndryshme rrisin mundësinë e zhvillimit të praktikave profesionale dhe të mundësive të punësimit.

**Pika të dobta**

1. Mungesa e stafit akademik të kualifikuar në këtë program studimi ku aktualisht është vetëm një staf akademik i kategorisë asistent lektor (MSc) në profilin Mjek Veteriner.
2. Ngarkesa shumë e madhe mësimore e disa prej asistentëve të këtij departamenti, duke venë në rrezik cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
3. Kërkesa e ulët dhe numri i ulët i studentëve në këtë program studimi.
4. Mungesë evidence për marrjen e masave në lidhje me rezultatet e anketimit të studentëve
5. Paqartësi nga ana e studentëve në lidhje me emërtimin e diplomës së tyre dhe nivelit të studimeve që ata kryejnë, duke hasur kështu edhe vështirësi në tregun e punës pas përfundimit të studimeve.

**Rekomandime**

1. GVJ sygjeron që departamenti dhe Fakulteti i Bujqësisë të marrin masa urgjente për rekrutimin e stafit të ri pedagogjik, specialistë të fushave përkatëse.
2. GVJ sygjeron që të merren masa për shpërndarjen më të mirë të ngarkesës mësimore mes stafit akademik përgjegjës për këtë program studimi.
3. GVJ sygjeron që të shtohen përpjekjet për të tërhequr studentë dhe rritur numrin e regjistrimeve për këtë program studimi.
4. GVJ sygjeron që të hartohen dhe merren masa për rezultatet e nxjerra nga anketimet e studentëve.
5. GVJ sygjeron një politikë informuese më intensive nga ana e institucionit për të qartësuar sa më shumë të jetë e mundur studentët e këtij programi.

**Conclusions of the Evaluation of the professional character study program "Veterinary Management" of the Institution of Higher Education "FanS. Noli" University", Korca**

**Strengths and affirmations**

1. Strategic professional program for the area, based mainly on the needs of the regional market.
2. Good employment opportunities in the regional market and beyond.
3. Responsible basic units, managers and academic staff, motivated and optimally engaged in achieving the objectives of the program and in supporting, orienting and encouraging students of the program.
4. Administrative staff motivated and committed to fulfilling the obligations arising from their job positions.
5. Adequate physical infrastructure.
6. Initial and continuous support from the Faculty of Veterinary Medicine at the Agricultural University of Tirana.
7. Cooperation agreements with local government, government institutions, various businesses increase the possibility of developing professional practices and employment opportunities

**Weaknesses**

1. Lack of qualified academic staff in this study program where currently there is only one academic staff of the category of assistant lecturer (MSc) in the profile of Veterinarian.
2. The very large teaching load hours of some of the assistants of this department, endangering the quality of teaching and learning.
3. Low demand and low number of students for this study program.
4. Lack of evidence for taking measures regarding the results of the student survey.
5. Uncertainty on the part of students regarding the name of their diploma and the level of studies they complete, thus encountering difficulties in the labor market after graduation.

**Recommendations**

1. EEG suggests that the department and the Faculty of Agriculture take urgent measures for the recruitment of new pedagogical staff, specialists in the respective fields.
2. EEG suggests that measures be taken to better distribute the teaching load among the academic staff responsible for this study program.
3. EEG suggests increasing efforts to attract students and increase the number of enrollments for this study program.
4. EEG suggests that measures be taken for the results obtained from student surveys.
5. EEG suggests a more intensive information policy by the institution to clarify as much as possible the students of this program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

